

Fletinformacion për çështjen gjyqësore

Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt (Numri i çështjes KSC-BC-2020-07 & KSC-CA-2022-01 & KSC-SC-2023-01)

HYSNI GUCATI



Kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

NASIM HARADINAJ



Nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Aktakuza	<p>Aktakuza fillestare u konfirmua më 11 dhjetor 2020 dhe u bë publike më 14 dhjetor 2020. Aktakuza e korrigjuar u dorëzua më 5 korrik 2021 ndërsa aktakuza me më pak redakte u dorëzua më 4 tetor 2021.</p> <p>Aktakuzën më të fundit mund ta gjeni këtu</p>
Aktgjykimi	<p>Gucati: U shpall fajtor për pesë nga gjashtë pikat e aktakuzës - u dënua me 4,5 vjet burgim dhe gjobë prej 100 eurosh.</p> <p>Haradinaj: U shpall fajtor për pesë nga gjashtë pikat e aktakuzës - u dënua me 4,5 vjet burgim dhe gjobë prej 100 eurosh.</p>
Aktgjykimi i apelit	<p>Gucati: i është ulur dënimi në katër vjet e tre muaj burgim dhe një gjobë prej 100 euro.</p> <p>Haradinaj: i është ulur dënimi në katër vjet e tre muaj burgim dhe një gjobë prej 100 euro.</p>
Gjykatës	<p>Gjykatës i procedurës paraprake: Nikola Giju;</p> <p>Trupi gjykues II: gjykatësit Çarls Smith III (kryesues), Kristof Barte, Genël Metro dhe Fergal Gejnor (gjykatës rezervë).</p> <p>Paneli i Gjykatës së Apelit: gjykatësit Mishelë Pikar (kryesues), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen</p> <p>Paneli i Gjykatës Supreme: gjykatësit Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vingart dhe Daniel Fransen</p>
Arrestimi/ Transferimi/ Paraqitja e parë	<p>Gucati: u arrestua më 25 shtator 2020 në Prishtinë, Kosovë; në të njëjtën ditë u transferua në Hagë; paraqitja e parë u mbajt më 18 dhjetor 2020: u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.</p> <p>Haradinaj: u arrestua më 25 shtator 2020 në Prishtinë, Kosovë; u transferua në Hagë më 26 shtator 2020; paraqitja e parë u mbajt më 18 dhjetor 2020: vendosi të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë brenda 30 ditësh; paraqitja e mëtejshme më 8 janar 2021: nuk u vetëdeklarua në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e tij, gjykatësi i procedurës paraprake bëri deklarinimin në emër të të akuzuarit se është i pafajshëm.</p>
Informacion i përgjithshëm	<p>Sipas aktakuzës, së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, në tre konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme, Gucati dhe Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm). Gucati dhe Haradinaj gjithashtu bënë akuzat dhe komente nënçmuese kundër dëshmitarëve (të mundshëm) dhe në mënyrë të përsëritur shprehen synimin e tyre për të dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara. Sipas aktakuzës, me këto veprime, Gucati dhe Haradinaj shkelën fshehtësinë e procedurës dhe frikësuan dëshmitarë (të mundshëm) të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe si pasojë penguan punën dhe hetimet e ZPS-së.</p>
Akuzat	<p>Gucati dhe Haradinaj akuzohen në bazë të përgjegjësisë penale individuale (neni 16(3) i Ligjit) për:</p> <p>Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (frikësim gjatë procedurës penale, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe neneve 387, 388(1) dhe 392(1)-(3) të Kodit Penal të Kosovës, Ligji nr. 06/L-074 (2019); dhe</p> <p>Vepra penale kundër rendit publik (Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 401(1)-(3) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës, Ligji nr. 06/L-074 (2019);</p>

Faza e çështjes gjyqësore	Kryerja e dënimit
----------------------------------	-------------------

Procedurat para Dhomave të Specializuara të Kosovës

PROCEDURA PARAPRAKE

Pas lëshimit të fletarrestimeve nga gjykatësi i vetëm, Gucati dhe Haradinaj u arrestuan në Prishtinë, Kosovë, më 25 shtator 2020, dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së përkatësisht më 25 dhe 26 shtator 2020.

Paraqitja e parë e Haradinajt dhe e Gucatit, si të dyshuar, para gjykatësit të vetëm, Nikola Giju, u mbajt përkatësisht më 29 shtator 2020 dhe më 1 tetor 2020.

Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake Nikola Giju, konfirmoi aktakuzën kundër dy të akuzuarve.

Seancat e paraqitjes së parë të Gucatit dhe Haradinajt u mbajtën më 18 dhjetor 2020 para gjykatësit të procedurës paraprake. Gucati u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës kurse Haradinaj vendosi të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë brenda 30 ditësh. Në paraqitjen e tij të mëtejshme më 8 janar 2021 Haradinaj nuk u vetëdeklarua në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e tij. Bazuar në rregullën 92(2)(f) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake bëri deklarinim në emër të të akuzuarit se është i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Më 27 gusht 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar e dorëzoi versionin e redaktuar publik të dosjes paraprake. Mbrojtja e Gucatit e dorëzoi atë më 2 shtator kurse Mbrojtja e Haradinajt e dorëzoi dosjen e saj paraprake “të përkohshme” më 12 korrik 2021.

Më 23 qershor 2021, paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht apelet e parashtuara nga Gucati dhe Haradinaj mbi mangësitë e pretenduara në formën e aktakuzës dhe urdhëroi që ZPS-ja të dorëzojë një version të korrigjuar të aktakuzës. Aktakuza e korrigjuar u dorëzua më 5 korrik 2021.

Më 16 korrik 2021, gjykatësi i procedurës paraprake ia kaloi dosjen e çështjes trupit gjykues II.

Konferenca përgatitore për gjykimin në këtë çështje u mbajt më 1 dhe 2 shtator, ndërsa Konferenca përgatitore e ZPS-së u mbajt më 8 shtator 2021.

PROCESI GJYQËSOR

Gjykimi filloi më 7 tetor 2021 me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar. Më 10 nëntor 2021, ZPS-ja e mbylli çështjen e vet.

Më 26 nëntor 2021, trupi gjykues hodhi poshtë mocionet e dorëzuara nga dy ekipet e Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave kundër të akuzuarëve, në bazë të rregullës 130 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DHSK-së.

Konferenca përgatitore për Mbrojtjen u mbajt më 2 dhjetor dhe Mbrojtja e Gucatit filloi paraqitjen e provave më 3 dhjetor 2021, ndjekur nga paraqitja e provave nga Mbrojtja e Haradinajt më 15 dhjetor 2021. Të dy ekipet e Mbrojtjes i përfunduan paraqitjet e provave të tyre më 2 shkurt 2022.

Paraqitja e provave në këtë çështje gjyqësore përfundoi më 3 shkurt 2022. ZPS-ja dhe Mbrojtja e Haradinajt i dorëzuan dosjet gjyqësore përfundimtare më 3 mars 2022, ndërsa Mbrojtja e Gucatit më 4 mars 2022. Më 16 mars 2022, Trupi Gjykues rifilloi procesin gjyqësor me qëllim pranimin e disa deklaratave të caktuara të dorëzuara nga Mbrojtja lidhur me përcaktimin e dënimit. Deklaratat përmbyllëse u bënë në periudhën 14-17 mars 2022.

Aktgjykimi u shpall më 18 maj 2022. Të dy të akuzuarit u shpallën fajtorë për:

- Pika 1, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes kërcënimit të rëndë,
- Pika 2, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi,
- Pika 3, frikësim gjatë procedurave penale,
- Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare,
- Pika 6, shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur.

Të dy të akuzuarit u shpallën të pafajshëm lidhur me Pikën 4, hakmarrje.

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, që të dy u dënuan me 4,5 vjet burgim, ku të llogaritet koha e kaluar në paraburgim deri tani, dhe u urdhëruan të paguajnë gjobë prej 100 eurosh deri më 18 korrik 2022.

Aktgjykimin e plotë mund ta gjeni [këtu](#).

Statistikat e Gjyimit			
Numri i ditëve të gjyimit: 32			
Numri i dëshmitarëve gjatë gjyimit	ZPS: 4	Mbrojtja e Gucati : 6 Mbrojtja e Haradinajt: 4	Përbërja e Trupit Gjykes: 0
Numri i dëshmimeve me shkrim të dëshmitarëve	ZPS: 0	Mbrojtja e Gucati : 12 Mbrojtja e Haradinajt: 6	Përbërja e Trupit Gjykes: 0
Numri i provave materialeve	ZPS: 169	Mbrojtja e Gucati: 46 Mbrojtja e Haradinajt: 20	Përbërja e Trupit Gjykes: 2
Zyra e Prokurorit të Specializuar	Mbrojtja		
Valeria Boliçi, Mat Halling, Xhejms Paqe	Gucati: Xhonëthën Ris (Mbrojtës), Hju Bouden (Bashkëmbrojtës) dhe Elenor Stivenson (Bashkëmbrojtës) Haradinaj: Tobi Kadman (Mbrojtës), Karl Baklli (Bashkëmbrojtës) dhe Almudena Bernabeu García (Bashkëmbrojtës)		

PROCEDURA PARA GJYKATËS SË APELIT

Gucati dhe Haradinaj i dorëzuan njoftimet për apel më 17 qershor 2022. ZPS-ja ka bërë të ditur se nuk ka ndërmend të apelojë aktgjykimin e shkallës së parë. Konferenca para apelit u mbajt më 5 korrik 2022.

Më 1 korrik, paneli i Gjykatës së Apelit, ndër të tjera për shkak të mospërbushjes së kriterëve të Udhëzuesit përkatës të Punës, anuloi tërësisht njoftimin e apelit të Haradinajt dhe e urdhëroi atë ta ridorëzojë njoftimin brenda një jave nga data e marrjes së këtij vendimi. Lidhur me njoftimin e apelit të Gucati, paneli anuloi vetëm pikën 18 dhe e urdhëroi atë të ridorëzojë njoftimin e tij të apelit brenda të njëjtit afat, në rast se ai dëshiron ta paraqesë përmbajtjen e asaj pike. Njoftimet për apel u ridorëzuan më 10 korrik (Haradinaj) dhe më 11 korrik 2022 (Gucati).

Hysni Gucati dorëzoi dosjen e apelit më 22 gusht 2022, ndërsa versioni i fundit i korrigjuar i dosjes së apelit të Haradinajt u dorëzua më 2 shtator 2022. Seanca e apelit u mbajt më 1 dhe 2 dhjetor 2022.

Aktgjykimi i apelit u shpall më 2 shkurt 2023. Paneli i Apelit la në fuqi verdiktin e fajësisë së Gucati dhe Haradinajt për frikësim gjatë procedurës penale (Pika 3), shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare (Pika 5), dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur (Pika 6). Paneli i Apelit më tej la në fuqi, me përjashtim të gjykatësit Ambos që nuk u pajtua, verdiktin e fajësisë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë (Pika 1). Paneli i Apelit prapësoi konstatimin e Trupit Gjykes për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (Pika 2) dhe i shpalli të pafajshëm Gucatin dhe Haradinajn për këtë Pikë. Bazuar në konstatimet e tyre, shumica e Panelit të Apelit uli dënimin nga katër vjet e gjysmë të dhënë nga Trupi Gjykes, në katër vjet e tre muaj burgim, duke llogaritur dhe kohën në paraburgim. Paneli i Apelit la në fuqi dënimin shtesë me një gjobë prej njëqind eurosh (100 euro).

Aktgjykimin e plotë mund ta gjeni [këtu](#).

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Metju Halling, Xhejms Paqe

Mbrojtja

Gucati: Xhonëthën Ris (Mbrojtës), Hju Bouden (Bashkëmbrojtës) dhe Elenor Stivenson (Bashkëmbrojtës)
Haradinaj: Tobi Kadman (Mbrojtës), Almudena Bernabeu García (Bashkëmbrojtës) dhe Xhon Kaben (Bashkëmbrojtës)

KËRKESAT PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË PARA GJYKATËS SUPREME

Më 2 dhe 3 maj 2023, përkatësisht, Haradinaj dhe Gucati dorëzuan kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në përputhje me nenet 48(6) to (8) të Ligjit dhe rregullën 193 të Rregullores. Rrjedhimisht, Kryetarja caktoi panelin e Gjykatës së Apelit, të përbërë nga gjykatësit Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vingart dhe Daniel Fransen për të vendosur për kërkesat. Më 9 maj 2023, Haradinaj ridorëzoi kërkesën e vet.

Më 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

ULJA, MODIFIKIMI OSE NDRYSHIMI I DËNIMEVE

Më 12 tetor 2023, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, vendosi të modifikojë dënimin e z. Hysni Gucati për lirimin e tij më 18 tetor 2023 ose rreth kësaj date, me kushtet e përcaktuara në vendim. Këto kushte do të jenë në fuqi gjatë pjesës së mbetur të dënimit të dhënë nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht për pjesën e mbetur të dënimit me katër vjet e tre muaj.

Hysni Gucati u lirua më 17 tetor 2023.

Më 12 tetor 2023, Kryetarja Trendafilova vendosi se ajo do të shqyrtojë modifikimin e vendimit të z. Nasim Haradinaj për lirimin e tij me disa kushte pasi të marrë raport prej Administratores Fidelma Donlon në lidhje me sjelljen e z. Haradinaj gjatë mbajtjes së tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Më 12 dhjetor 2023, Kryetarja vendosi të modifikojë dënimin e Nasim Haradinajt për lirimin e tij më 14 dhjetor ose rreth kësaj date, sipas kushteve të përcaktuara në vendim. Këto kushte do të jenë në fuqi gjatë pjesës së mbetur të dënimit të dhënë nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht për pjesën e mbetur të dënimit me katër vjet e tre muaj.

Haradinaj u lirua më 14 dhjetor 2023.